



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06/IA001, IA002, IA003 & IA004

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 4 shkurt 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Kai Ambos

Gjykatëse Nina Jorgensen

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit:

Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit:

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit:

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagenda

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c), 41(10) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullave 58, 169 dhe 170 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me apelet e ndërmjetme të zotërinjve Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi (“të akuzuarit”) ndaj vendimeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për refuzimin e kërkesave të tyre për lirim të përkohshëm (bashkërisht “Apeli”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 nëntor 2020, z. Krasniqi u arrestua në Kosovë në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 26 tetor 2020² dhe u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë në të njëjtën ditë.³

2. Më 5 nëntor 2020, zotërinjtë Thaçi, Veseli dhe Selimi u arrestuan në Kosovë në bazë

¹ AI001/F00001, Kërkesë e Mbrojtjes për apelin e “Vendimit mbi kërkesën e Kadri Veselit për lirim të përkohshëm”, 1 shkurt 2021 (“Apeli i Veselit”); AI002-F00001/RED, Version i redaktuar publik i apelit të Mbrojtjes së Krasniqit ndaj vendimit mbi kërkesën e Jakup Krasniqit për lirim të përkohshëm, KSC-BC-2020-06/AI002/F00001, datë 3 shkurt 2021, 3 shkurt 2021 (“Apeli i Krasniqit”); AI003/F0001/RED, Version i redaktuar publik i apelit ndaj vendimit mbi kërkesën e Rexhep Selimit për lirim të përkohshëm, KSC-BC-2020-06/IA003-F00001, datë 3 shkurt 2021, 3 shkurt 2021 (“Apeli i Selimit”); AI004/F0001/RED, Version i redaktuar publik i apelit të Mbrojtjes së Thaçit ndaj “Vendimit mbi kërkesën e Hashim Thaçit për lirim të përkohshëm” me shtojcat publike 1 dhe 2, 4 shkurt 2021.

² Shih, F00027, Version i redaktuar publik i vendimit mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi, 26 tetor 2020 (“Vendimi mbi fletarrestimet”).

³ Shih, F00048, Njoftim për pranimin e Jakup Krasniqit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 4 nëntor 2020.

të fletarrestimeve të lëshuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 26 tetor 2020⁴ dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë në të njëjtën ditë.⁵

3. Më 22 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë kërkesat e të akuzuarve për lirim të përkohshëm (“vendimet e kontestuara”).⁶

4. Më 1 shkurt 2021, z. Veseli e apeloj vendimin e kontestuar.⁷

5. Më 3 shkurt, zotërinjtë Thaçi, Selimi dhe Krasniqi i apelian vendimet e kontestuara.⁸

II. CAKTIMI

6. Pas shqyrtimit të kriterëve të parashikuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM ÇAKTON:

⁴ Shih, Vendimi mbi fletarrestimet.

⁵ Shih, F00053, Njoftimi i pranimit të Hashim Thaçit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe mbi emërimin e Mbrojtësit, 5 nëntor 2020; F00054, Njoftimi i pranimit të Kadri Veselit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe emërimin të Mbrojtësit, 5 nëntor 2020; F00055, Njoftimi i pranimit të Rexhep Selimit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 5 nëntor 2020.

⁶ F00094, Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për lirim të përkohshëm, 22 janar 2021, para. 64; F00177/RED, Version i redaktuar publik i vendimit mbi kërkesën për lirim të përkohshëm të Hashim Thaçit, 22 janar 2021, i protokolluar më 26 janar 2021, para. 61; F00179/RED, Version i redaktuar publik i vendimit mbi kërkesën e Rexhep Selimit për lirim të përkohshëm, 22 janar 2021, i protokolluar më 26 janar 2021, para. 58; F00180/RED, Version i redaktuar publik i vendimit mbi kërkesën e Jakup Krasniqit për lirim të përkohshëm, 22 janar 2021, i protokolluar më 26 janar 2021, para. 52.

⁷ Shih në përgjithësi, Apeli i Veselit.

⁸ Shih në përgjithësi, Apeli i Thaçit; Apeli i Selimit; Apeli i Krasniqit.

**Gjykatësen Mishelë Pikar
Gjykatësin Kai Ambos
Gjykatësen Nina Jorgensen**

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur për apelet.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E enjte, 4 shkurt 2021
Në Hagë,
Holandë.